

VENDIM
Nr. 32, datë 13.9.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KKRR-së NR. 28, DATË 23.6.2023,
“PËR SHTYRJE AFATI TË APLIKIMIT NGA SHOQËRITË UJËSJELLËS-
KANALIZIME PËR TARIFA TË UJIT TË PIJSHËM DHE UJËRAVE TË
NDOTURA PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR),

KONSTATOI SE:

Në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, neni 14, pika “b”, përcaktohet se një ndër kompetencat e KKRR-së është *“të miratojë çmimet dhe tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për ujërat e përdorura dhe tarifat e trajtimit të tyre...”*. Gjithashtu në nenin 22 të po këtij ligji përcaktohen procedurat për vendosjen e tarifave, ku në zbatim të këtij ligji, KKRR-ja përcakton metodologjinë e përlllogaritjes së tarifave e cila është miratuar me vendimin nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”.

Me miratimin e VKM nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” është realizuar agregimi i 12 shoqërive ujësjellës kanalizime nga 15, por që për arsye objektive nuk është përfunduar plotësisht procesi i riorganizimit të brendshëm në shoqëritë e reja rajonale. Neni 10, pika 4 e vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 përcakton se *“Afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave është data 30 qershor”*. Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendim nr. 28, datë 23.6.2023, vendosi se përjashtimisht për vitin 2023, afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave për shoqëritë UK rajonale është data 31 gusht 2023.

Me shkresën nr. 1608 prot., datë 8.9.2023, me lëndë “Kërkesë për shtyrje afati për paraqitjen e dokumenteve për aplikimin e nivelit të ri të tarifave” AKUM-ja ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të aplikimeve për tarifa deri më datë 30 shtator 2023 nga ana e shoqërive UK, me arsyetimin e problematikave të hasura nga shoqëritë e riorganizuara gjatë kësaj periudhe, si: konstituimi i këshillave të rinj bashkiakë dhe periudhës së ngarkuar nga shoqëritë rajonale UK si rezultat i fluksit të madh turistik në zonat bregdetare dhe ato malore.

Sa më sipër, në mbledhjen e datës 13.9.2023, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Përjashtimisht për vitin 2023, afati përfundimtar për paraqitjen e dokumentacionit të plotë të aplikimit për nivel të ri të tarifave për shoqëritë SKP/UK është data 30 shtator 2023.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë rajonale ujësjellës-kanalizime dhe të gjitha strukturat e Entit Rregullator të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani